



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.997/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare, Faton Bajrami dhe Franciska Zhitia Ymeri, anëtar në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Solution” Sh.P.K me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK), në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditurës, ushtruar kundër Aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.868/19, të datës 03.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.09.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal A.nr.868/19, të datës 03.06.2021, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.868/19, të datës 03.06.2021 është Aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit NT “Solution” Sh.P.K me seli në Prishtinë. Anullohet aktvendimi nr.07.3/1851/2015 i datës 01.03.2019 i Doganës së Kosovës në Prishtinë. Obligohet e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë që paditësit t’ia kthej shumën prej 13,524.00€ (trembëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet e katër euro e zero cent) të paguar nga paditësi në emër të taksës doganore prej 10% dhe Tatimit Mbi Vlerën e Shtuar prej 16%, për mallin e zhdoganuar përmes Deklaratës Unike Doganore me nr. R-13737/05.12.2014 të proceduar në Zyrën Doganore Aeroporti i

Prishtinës – Terminal, si dhe t'ia kthej shumën prej 4,000.00€ (katërmijë euro) të paguar nga paditësi në emër të kundërvajtjes doganore si rezultat i ndryshimit të kodit tarifor nga kodi me nr.9018908400 i deklaruar nga paditësi në kodin tarifor me nr. 8543709090 të ndryshuar nga e paditura, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data e pagesës së detyrimeve importuese dhe kundërvajtëse doganore 22.12.2014 e deri në pagesën e plotë të kësaj shume, në afat prej 15 ditës nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka ushtruar e paditura për shkak të: zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje esenciale të dispozitave të procedurës LKA. Me propozim që të aprovohet e bazuar ankesa në tërësi si të bazuar me ligj, të prish Aktgjykimin A.nr.868/19 të datës 03.06.2021 si të pa bazuar në ligj, ta refuzon padinë dhe kërkesën e paditësit në tërësi si të pabazuar me ligj dhe të lënë në fuqi aktvendimin e kontestuar ose t'ia kthej gjykatës në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale- Dhoma e Shkallës së dytë. shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar nr.07.3/1851/2015 i datës 01.03.2019 të Doganës së Kosovës në Prishtinë, është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e subjektit në procedurë “Solution D” Sh.P.K me seli në Prishtinë, për rishqyrtimin e aktvendimit nr. 3536/2014 të datës 17.12.2014 i lëshuar nga Drejtoria Rajonale Prishtinë – Njësi i PAKD-së si e pa bazuar.

Paditësi i pakënaqur me aktvendimin e lartcekur të Doganës së Kosovës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i paligjshëm. Gjykata e shkallës së parë,

pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër aktvendimit nr.07.3/1851/2015 i datës 01.03.2019 të Doganës së Kosovës në Prishtinë, e pas administrimit të provave si në procesverbale të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke refuzuar aktvendimin e lartcekur të Doganës së Kosovës në Prishtinë. Me arsyetim se nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ konstaton se e paditura në rastin konkret pa bazë ligjore dhe në kundërshtim me provat në dispozicion e ka ndryshuar kodin tarifor për mallin e deklaruar nga paditësi përmes DUD-it nr. R-13737/05.12.2014 ku kodi tarifor ishte deklaruar nga paditësi me nr. 9018908400 sipas dokumentacionit përcjellës të mallit e ku sipas këtij kodi malli lëndor *“Lumenis Ligter Desire XC, Lumenis Light Sheer HS Handpeiese”*, është liruar nga taksa doganore dhe TVSh-ja, bazuar në TARIK-2014, Ligjin nr.04/L-163 për Mallrat e Liruara nga Tatimi Doganor dhe Mallrat me Tarifë Zero të Tatimit Doganor (i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës nr.2/16 janar 2014) i cili ka hyrë në fuqi me datë 31.01.2014, përkatësisht aneksi I, pjesa B e tij, ku në kodin tarifor me numër 9018, përfshihen: *“instrumentet dhe aparatet që shfrytëzohen në shkresat e mjekësisë, kirurgjisë, stomatologjisë dhe veterinarisë, duke përfshirë aparatet scientigrafike, aparatet tjera elektromedicinale dhe instrumentet për testimin e të pamurit”* si dhe neni 30 par.1 nën par.1.25 i Ligjit nr. 03/L-146 për TVSH, si ligj i aplikueshëm në rastin konkret ku është paraparë se *“Lidhur me mallrat e importuara dhe lëshimin e tyre në qarkullim të lirë në pajtueshmëri me kushtet dhe afatet kohore të caktuara në Legjislacionin Doganor nga TVSH duhet të lirohen si në vijim: 1.25. barnat, produktet farmaceutike, Instrumentet dhe aparaturat mjekësore dhe kirurgjike”* në kodin tarifor me nr.8543709090, sipas të cilit kod për mallin lëndor duhet të paguhet taksa doganore prej 10% dhe TVSH-ja prej 16%. Gjykata e ka vërtetuar faktin se paditësit i është lëshuar autorizimi për Import të Pajisjeve Medicinale me nr. 2024/2014 i datës 26.11.2014, për produktin *“Lumenis Ligter Desire XC”*, nga prodhuesi *“Lumenis LTD”* sipas pro faturës me nr. B-00474-2014, për periudhën deri me datë 25.02.2015, në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje Dhoma e

Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale i heton sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejt ka konstatuar se padia e paditësit është e pabazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, meqë gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave LKA-së, Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, si dhe të LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se gjykata e shkallës së parë nuk i ka administruar provat për të vërtetuar gjendjen faktike, por ato vetëm i ka përmendur dhe ka nxjerrë konkluzion të gabuar duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, dhe këtë e vërteton fakti se gjykata gabimisht ka konstatuar se e paditura nuk ka vërtetuar saktë gjendjen faktike, pastaj se, gjykata gabimisht konstaton se në rastin konkret ka bazë ligjore për t'iu referuar Informatës Detyruese Tarifore (BTI). Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoj, ngase të njëjtat janë të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Sepse e paditura me asnjë provë nuk i vërteton pretendimet e saj, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vlerësuar se e paditura vendimin kontestues edhe pse e ka nxjerr në ri procedurë duke vepruar në zbatim të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.668/15 të datës 15.10.2018, ajo nuk i ka respektuar pikëpamjet juridike të gjykatës, pra ka nxjerr vendim në kundërshtim me udhëzimet dhe vërejtjet e gjykatës dhe në këtë mënyrë nuk i ka respektuar detyrimet ligjore nga neni 65 i LKA-së. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar që e paditura në rivendosje ishte obliguar nga

gjykata, që të kërkoj nga Sektori i Tarifës që edhe një herë të nxjerr me mendim të ri tarifor lidhur me mallin lëndor të deklaruar me DUD-in kontestues sipas përshkrimit të mallit në dokumentet përcjellëse të mallit ashtu që mendimin e vet profesional ta mbështet në shënimet e TARIK-ut, faturën, BTI-në nga UE për llojin e mallit, si dhe të verifikoj dokumentacionin përcjellës të mallit, si dhe të shqyrtoj pretendimet e paditësit lidhur me përshkrimin e mallit lëndor kur e ka ngarkuar paditësin me taksën doganore prej 10% mirëpo e paditura në ri procedurë nuk ka vepruar fare komfor këtyre udhëzimeve por i ka mjaftuar konstatimi se është kërkuar mendim për tarifimin e mallit me të dhënat e bashkangjitura duke e përfshirë BTI-në e dorëzuar nga subjekti në procedurë, por nga Sektori i Tarifës është pranuar konfirmimi se edhe pas analizimit të rastit Sektori i Tarifës qëndron prapa mendimit të dhënë më parë për këtë rast duke sqaruar se pajisja depiluese për trajtim të lëkurës klasifikohet në 8543. Tutje gjykata ka konstatuar se paditësi për të dëshmuar kodin tarifor të deklaruar për mallin lëndor në këtë procedurë gjyqësore të konfliktit administrativ, komfor dispozitave të nenit 123 të UA nr.11/2009 Për Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave, ka paraqitur dokumentacion relevant, respektivisht ka paraqitur pro faturën e mallit me B-00474-2014 të datës 20.11.2014, ku është i shënuar numri tarifor i mallit 901890850, ka paraqitur faturën e mallit me nr. B-535-2014 të datës 03.12.2014, ku është shënuar numri tarifor i njëjtë i mallit lëndor, ka paraqitur kontratën e shitjes të lidhur me eksportuesin “Extreme” DOO nga Sllovenia të datës 24.11.2014, ka paraqitur deklaratën e konformitetit EC të lëshuar nga prodhuesi i mallit lëndor “Lumenis” LTD nga Israeli, Deklaratën e prodhuesit për autoritetet doganore të Republikës së Kosovës të datës 15.12.2014 ku konfirmohet numri tarifor i mallit lëndor 901890850 si pajisje mjekësore, pastaj ka paraqitur deklaratën e eksportuesit “Extreme” DOO nga Sllovenia të datës 16.12.2014 ku sërish konfirmohet kodi tarifor i njëjtë për mallin lëndor dhe cilësimi i mallit lëndor si pajisje mjekësore, si dhe ka paraqitur Informatën për Tarifat e Detyrueshme BTI me nr. reference SE TIL 2015-3687 të lëshuar nga Komunitetet Evropiane – Dogana e Suedisë, ku vërtetohet se malli lëndor “Lightsheer Desire” me përshkrim si *“Sistem laserik trajtimi, laser kirurgjik jo invaziv dhe estetik, me gjatësi valore të diodës prej 805nm. Sistemi përbëhet nga konzula e sistemit (sistem monitorimi dhe kontrolli), paneli me ekran, si dhe telekomandues të dorës, dhe sipas informatave kjo pajisje përdoret mes tjerash për heqjen e qimeve, reduktimin e përhershëm të rritjes së qimeve, trajtimin e lezioneve të pigmentuara, lezioneve vaskulare. Pseudofolluculitis barbae dhe venave varikoze, si dhe aplikime të tjera estetike e kozmetike në dermatologji dhe*

kirurgji plastike”, klasifikohet në nomenklaturën e autoritetit doganor në numrin 90189084, klasifikim ky i cili bazohet në bazë të dispozitave të përgjithshme 1 dhe 6 për interpretimin e Nomenklaturës së Kombinar, rasti C-574 i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, si dhe në bazë të tekstit KN-nr.9018, 901890 dhe 90189084.

Kolegji i kësaj gjyqate, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, gjen se gjykata e shkallës së parë, nga dëshmitë e nxjerra me të drejt ka konstatuar se Dogana e Kosovës, në mënyrë të gabuar ka vërtetuar gjendjen faktike sikurse edhe nga faktet e vërtetuara është nxjerr konkluzion jo i drejtë në pikëpamjet të gjendjes faktike për pasoj edhe dispozitat ligjore nuk janë aplikuar drejtë përkundër të gjitha dokumenteve, ku ndryshimin e kodit tarifor për paditësin dhe obligimin me pagesën e taksave doganore në shumë prej 13,524.00€ si dhe gjobë administrative në shumë prej 4,000.00€ në emër të kundërvajtjes doganore të shqiptuar sipas aktvendimit me nr. 3536/2014 i datës 17.12.2014 e ka bazuar vetëm në mendimin për klasifikim tarifor nr.04.3 nr.139/09.12.2014 të nxjerr nga Sektori i Tarifës i cili vepruar në kuadër të paditurës e i cili sektor vet në këtë mendim të nxjerr për klasifikimin tarifor të mallit të deklaruar nga paditësi, përmes DUD-it R-13737 të datës 05.12.2014 nuk ka qenë i sigurt pasi që është shprehur se: *“mendojmë se nuk është deklarim i duhur pasi që aparati Lumenis Lihgt Sheer Desire XC është aparat me sistem laseri që emiton dritë infra të kuqe impulsive, me qëllim të largimit të flokëve, trajtimin e lëkurës, trajtimin e venave, pigmenteve etj”*. Prandaj, kolegji i kësaj gjyqate nuk i merr si të bazuara pretendimet e të paditurës se gabimisht është vërtetuar gjendjen faktike, dhe me këtë rast gabimisht kanë aplikuar edhe dispozitat ligjore. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjyqate, aktgjykimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm, dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejt, kur është bazuar në dispozitat e LPA, LKA, Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, nr.03/L-222.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet e të paditurës të përsëritura të një pas njëshme ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara, për tu aprovuar

ankesa, dhe për faktin se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyet e mjaftueshme të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të padisë së paditësit dhe refuzimit të aktvendimit të lartcekur, e pasi që me thëniet ankimore një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.DH.SH.II.nr.997/22, me datë 05.09.2023

**Kryetare e kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti**